



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:176168  
Datë: 05.04.2024  
Numri i dokumentit: 05554309

Ac.nr.723/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KUR Mitrovica sh.a., me seli në Mitrovicë, rr. “Bislim Bajgora” pn., kundër debitorit I. Sh. nga Mitrovica, rr. “ ....”, me bazë juridike përmbarimore borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.518/2021, datë 13.12.2021, më 03.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit I.Sh. nga Mitrovica, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.518/2021, i datës 13.12.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.518/2021, të datës 13.12.2021, ka vendosur si në vijim:

APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit I.Sh. nga Mitrovica, ashtu që:

SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi lejimin e Përmbarimit P.nr.124/2021 të dt: 25.02.2021 për periudhën kohore dt. 01.01.2013 e gjer me dt. 31.12.2019 në shumë prej

1,109.47€ dhe OBLIGOHET debitori që kreditorit KUR Mitrovica sh.a., rr. “...” Mitrovicë, në emër të borxhit për ujin e harxhuar për periudhën kohore dt. 31.01.2020 e gjer me dt. 28.02.2021 t’ia paguaj shumën prej 1.058.11€, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi e deri ne pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë debitori, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ta shfuqizoj urdhërin për përmbarim sa i përket faturës së datës 30.06.2021, në shumë prej 929.83€, ndërsa ta lë në fuqi borxhin në shumë prej 128.28€, apo aktvendimin ta anuloj dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja KUR Mitrovica sh.a., me seli në Mitrovicë, rr. “Bislim Bajgora” pn., ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste Code ....., lidhur me shumën e detyrimit të debitorit I.Sh. nga Mitrovica, për shpenzimet e ujit në lartësi prej 2,167.58 €, për periudhën prej 01.01.2013 deri me datën 31.12.2019.

Përmbaruesi privat A.M., me urdhrin P.nr.124/21, të datës 25.02.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit, gjersa ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori ka ushtruar prapësim me datë 09.03.2021. Përfundimisht, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, me arsytet e parashtruara si në aktvendim.

Gjykata e Apelit, me referim në pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, gjen se pretendimi i debitorit është i pabazuar meqë nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion dhe ka konstatuar faktin se debitori për periudhën kohore prej datës 01.01.2013 e deri me datën 31.12.2019, ka bërë disa pagesa, mirëpo në këtë rast nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak, apo në emër të faturave për muajt vijues. Marrë parasysh që ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka pasur marrëveshje për riprogramim eventuale të borxhit, andaj gjykata ka konsideruar se këto pagesa në këtë rast nuk e kanë ndërprerë parashkrimin. Në kuptim të njëjtë dhe mbi bazën e dokumentit të njëjtë të besueshëm, respektivisht ekstraktit nga librat afarist, gjykata e shkallës së parë duke gjetur se një pjesë e borxhit nuk është parashkruar, kështu

e detyroi debitorin që kreditorit t'i paguaj shumën prej 1058.11€, në emër të borxhit për ujin e harxhuar gjatë periudhës kohore nga data 31.01.2020, e deri me datë 28.02.2021.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë aktvendimi i atakuar është rezultat i vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sa i përket shumës së detyrimit të debitorit në raport me kreditorin, pasi lartësia e detyrimit e cila nuk është parashkruar është vërtetuar në tërësi nga dokumenti i besueshëm mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura konkrete përbarimore, ndërsa gjykata e çështjes në raport me rrethanat dhe faktet e rastit drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, duke e lejuar përbarimin në çështjen konkrete gjersa vendimi si i tillë ka mbështetje ligjore në dispozitën e nenit 21 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Organi përbariues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbariues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Po ashtu edhe me dispozitën e nenit 29 të LPP-së parashihet se për realizimin e kërkesës në të holla, përbarimi mund të caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm, e si dokument i besueshëm në kuptim të nenit të lartcekur konsiderohet ndër të tjera edhe ekstrakti i verifikuar nga librat afariste.

Sipas dispozitave të LPP-së, përkatësisht nenit 37 të LPP-së, *“kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, ndërsa sipas nenit 29 par.3 të LPP-së *“dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.*

Kështu, pas shikimit të shkresave të lëndës, rezulton se kreditori, propozimit për përbarim i ka bashkëngjitur dokumentin e besueshëm, përkatësisht ekstraktin nga librat afariste nr. Code ..., i cili në rastin konkret i përmbushë kushtet për të qenë i përshtatshëm për përbarim dhe në shumën e detyrimit, e cila sipas gjetjeve të gjykatës dhe me referim në dispozitat e ligjit material nuk është parashkruar. Në këtë drejtim pretendimi i debitorit sa i përket gjendjes teknike të njehsorit dhe pasaktësisë së faturave për shpenzimet e ujit për gjykatën ankimore nuk janë relevante përderisa procedura përbarimore si rregull i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk mund të vlerësohen rrethana tjera, përpos elementeve formale të dokumentit përbariues si dhe përshtatshmërisë së dokumentit përbariues, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë me vëmendje i ka vlerësuar faktet vendimtare mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura, duke shqyrtuar edhe pretendimet nga prapësimi i debitorit dhe pas shqyrtimit të gjithmbarshëm të prove shkresore, ka ardhur në përfundimin e drejtë si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar, duke e lënë pjesërisht në fuqi urdhrin përbarimor sa i përket vlerës së detyrimit për periudhën kohore dhe shumën e detyrimit e cila shumë nuk është parashkruar në kuptim të dispozitave të nenit 360 dhe 369 të LMD.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

Numri i lëndës: 2021:176168  
Datë: 05.04.2024  
Numri i dokumentit: 05554309

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

Ac.nr.723/22, më 03.04.2024

Gjyqtarja

Hunaida Pasuli